

## Si të sigurohem që të kuptoj atë që thotë mjeku?

- + Përdorni një përkthyes të trajnuar
- + Bëni pyetje
- + Përsëritjani mjekut çfarë keni kuptuar

Mos harroni, nuk ka problem nëse i tregoni mjekut që nuk keni kuptuar diçka.

Për më shumë informacion lidhur me shërbimet gjuhësore, telefononi **1-844-692-4692**



Kujdesi për NYC. Pa përjashtime.

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**



Qëndroni të informuar. Na ndiqni.

[www.nychealthandhospitals.org](http://www.nychealthandhospitals.org)

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**

# Ne flasim gjuhën tuaj

Merrni ndihmë nëse gjuha juaj e preferuar nuk është anglishtja



Në NYC Health + Hospitals, ne flasim më shumë se 300 gjuhë, përfshirë Gjuhën Amerikane të Shenjave (American Sign Language, ASL).

Kërkoni një përkthyes që flet gjuhën tuaj të preferuar. Një përkthyes mund t'ju ndihmojë të merrni kujdesin më të mirë për veten dhe familjen tuaj.



Është e drejta juaj të keni një përkthyes kur të vini në NYC Health + Hospitals. Dhe është FALAS!

### **Pse është e rëndësishme të përdorni një përkthyes?**

Kur keni një përkthyes, ju:

- + Mund të ndani informacione me ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor
- + Merrni informacionin që ju nevojitet për t'u kujdesur për shëndetin tuaj
- + Merrni përgjigje për të gjitha pyetjet tuaja
- + Merrni kujdesin më të mirë të mundshëm

Gjëja më e mirë është të keni një përkthyes të trajnuar. Një përkthyes i trajnuar është dikush që:

- + Është ekspert si në anglisht ashtu edhe në gjuhën tuaj të preferuar
- + Ka njohuri për kulturën tuaj
- + Ka trajnim të posaçëm për t'ju ndihmuar ju dhe mjekun të kuptoni njëri-tjetrin

Disa njerëz kërkojnë ndihmën e një miku ose të një pjesëtari të familjes, përfshirë fëmijët, për ndihmë për të folur me mjekët. Megjithatë, ata zakonisht nuk janë të trajnuar të jenë përkthyes mjekësorë. Ne rekomandojmë përdorimin vetëm të një përkthyesi mjekësor të trajnuar.

### **Si mund të gjej një përkthyes?**

- + Përdorni aplikacionin në telefonin tuaj ose mbani me vete një kartë që tregon gjuhën që flisni dhe tregojani personave të kujdesit shëndetësor.
- + Thuajuni personave të kujdesit shëndetësor se dëshironi një përkthyes



Kur nuk përdoret një përkthyes i trajnuar, rreziku i bërjes së gabimeve të rënda që mund të ndikojnë te shëndeti i një pacienti është 2 herë më i lartë.

### **Unë flas pak anglisht. A mund të kem gjithsesi një përkthyes?**

Po! Edhe nëse flisni pak anglisht, është e rëndësishme të dëgjoni informacion në lidhje me shëndetin tuaj në gjuhën që preferoni të flisni. Ndonjëherë fjalët mjekësore janë më të lehta për t'u kuptuar në gjuhën tuaj amtare.

### **Ne ofrojmë 3 lloje përkthimi:**

**Me telefon**

**Me video**

**Personalisht**

Disa nga këto opsione mund të mos jenë gjithmonë të disponueshme në çdo kohë, por mund t'i tregoni personave të kujdesit shëndetësor se çfarë dëshironi më mirë.

